



Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za
Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu / Department of Health and Social Welfare

Nr: 04-016/01-27360/26

Datë: 15/04/2026

Në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr: 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nxjerr këtë :

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE

Për mbështetje financiare publike për projekte/programme, të organizatave jo-qeveritare në fushën e mirëqenies sociale.

-I-

1. Për implementimin e thirrjes publike, do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ^{ve}.
2. Mbështetja financiare publike për projekt/programet e OJQ^{ve}, nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kodit ekonomik: nr.10/651/73036/21200/00000/0760 dhe kodit : nr. 21/651/73036/21200/00000/0760, në kuadër të programit/nënprogramit/ të subvencioneve.

-II-

1. Mjetet do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ^{ve}.

Sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

-III-

1. Dokumentacioni i zbatimit të thirrjes publike sipas pikës II, të këtij Vendimi përfshinë:

1. Tekstin e thirrjes publike
2. Udhëzimin për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1, të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaratës së mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ^{ve}, të financuara nga burimet publike
6. Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktivitetëve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

-IV-

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (**web faqe**).

-V-

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ^{te} dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijoj një komision vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1, të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

-VI-

1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
 2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njëtoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
- Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

-VII-

Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe protokolimit



Drejtoresha e DSHMS-së

Mimoza Kadriu Qerimi